



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 510/4 Prot

Tiranë, më 25.06.2020

**V E N D I M**

Nr.43, datë 25.06.2020

**“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë, në lidhje me zbatimin e aktit nr. 2181, datë 20.5.2020 të DAP, për nëpunësin \*\*\*\*\*”**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara nenet 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenit 90, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit \*\*\*\*\*,

**Vërej se:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.510 prot., datë 5.6.2020, nëpunësi \*\*\*\*\* ka parashtruar pretendimin se, nga ana e institucionit Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nuk veprohet për zbatimin e aktit të Departamentit të Administratës Publike, me anë të të cilit është urdhëruar rikthimi i nëpunësit në fjalë, në pozicionin e mëparshëm të punës si “Kryeinspektor në ISHPSHSH, Dega Rajonale Tiranë”, pas mbarimit të afatit të transferimit të përkohshëm 6-mujor në pozicionin “Kryeinspektor në ISHPSHSH, Dega Rajonale Elbasan”.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar për këtë rast, konstatohet se, nëpunësi \*\*\*\*\* i emëruar rregullisht në pozicionin “Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë”, nëpërmjet aktit nr.2266, datë 7.11.2019, të titullarit të institucionit, miratuar nga njësia përgjegjëse me aktin nr. 6662/1, datë 7.11.2019, për nevoja të institucionit është transferuar për 6 muaj, në detyrën “Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Elbasan”.

Në mbarim të afatit të transferimit të përkohshëm, në zbatim të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 2181, datë 20.5.2020, ka urdhëruar kthimin e punonjësit në fjalë, në pozicionin e punës që mbante para transferimit, *“Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë”*, akt i cili nuk është zbatuar nga ana e institucionit, veprim që përbën dhe objektin e mosmarrëveshjes në shqyrtim.

Për verifikimin e këtij rasti, Komisioneri, me shkresën nr. 510/1 prot., datë 12.6.2020, *“Kërkohet informacion në lidhje me zbatimin e aktit të DAP për rikthimin në pozicionin e mëpërshëm të punës të punonjësit \*\*\*\*\*”*, drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i ka kërkuar spjegime njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, në lidhje me shkakun e krijimit të kësaj situatë paligjshmërie.

Në përgjigje të kësaj kërkesë për informacion, institucioni Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ka dërguar shkresën nr. 1180/1 prot., datë 17.6.2020, *“Kthim përgjigje shkresës nr. 510/1 prot., datë 12.6.2020”*, nëpërmjet të cilës parashtron se, ndaj nëpunësit në fjalë, në bazë të rekomandimeve të lëna në përfundim të një auditimi të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka filluar ecuria disiplinore dhe çështja i ka kaluar për shqyrtim Komisionit të Disiplinës, ngritur për këtë qëllim dhe se vetëm pas përfundimit të procedimit disiplinor, do të informojë Komisionerin për veprimet e mëtejshme.

Duke patur parasysh sa më sipër, në analizë të fakteve dhe të akteve ligjore përkatëse, konstatojmë që, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, atribut ky që i njihet në bazë të nenit 4, pika 1, shkronja *“f”*, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, me aktin nr. 2181, datë 20.5.2020, ka njoftuar institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, se nëpunësit \*\*\*\*\*, i ka përfunduar afati i transferimit të përkohshëm në pozicionin *“Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Elbasan”* dhe në bazë të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe pikës 12, Kreu I, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, duhet të kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës, *“Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë”*.

Pretendimi i ngritur nga ana e institucionit për moszbatimin e këtij akti të DAP, për shkak se është në pritje të përfundimit të një procedimi disiplinor për këtë punonjës, nuk mund të pranohet pasi, rekomandimi i një institucioni kontrolli për vënie para përgjegjësisë disiplinore të një nëpunësi, është një çështje në kompetencë të Komisionit të Disiplinës, i cili ka diskrecionin për të vendosur përfundimisht nëse do të vazhdojë procedimi administrativ

duke marrë një masë të përshtatshme disiplinore apo do ta ndërpresë atë, për shkak se, në veprimet apo mosveprimet e nëpunësit, nuk gjenden elementë të shkeljes disiplinore.

Ky diskrecion i një organi kolegjal siç është Komisioni i Disiplinës, nuk i jep të drejtën drejtuesit të institucionit, që të paragjykojë dhe të pranojë apriori, përgjegjësinë e nëpunësit që është duke u proceduar nga pikpamja disiplinore. Komisioni i Disiplinës, në përputhje me çështjen konkrete dhe provat e administruara pas kryerjes së hetimit administrativ, është autoriteti që vlerëson nivelin e përgjegjshmërisë disiplinore të nëpunësit të proceduar dhe cakton një masë të përshtatshme disiplinore, bazuar në nenin 60, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Për sa kohë ai nuk është shprehur, askush nuk ka të drejtë, që për një fakt të paqenë, të paragjykojë dhe refuzojë zbatimin e një akti të ligjshëm të Departamentit të Administratës Publike.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga titullari i institucionit Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, kryerjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të aktit nr. 2181, datë 20.5.2020, të Departamentit të Administratës Publike, duke kthyer nëpunësin \*\*\*\*\* në pozicionin e tij të punës *“Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë”*.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit

civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

5. Të njoftohen për këtë vendim, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Departamenti i Administratës Publike, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**